



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 68, datë 3.2.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RIFORCIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË BIBLIOTEKËS
“GJERGJ FISHTA” DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës “Gjergj Fishta”, Bashkia Lezhë, në vlerën 117 000 000 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH.
2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, për financimin e rforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës “Gjergj Fishta”, Bashkia Lezhë, të jetë në vlerën 23 400 000 (njëzet e tre milionë e katërqind mijë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.
3. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për rforcimin dhe rikonstruksionin e bibliotekës “Gjergj Fishta”.

4. Fondi për financimin rforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës “Gjergj Fishta” i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.
5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN
ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 663/1
DATË 5.2.2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË LEZHË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

